



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A

Tiranë, më 18.03.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të integruara të sigurisë (sisteme CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto) dhe platformës së monitorimit të Posta Shqiptare sh.a”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sisteme sigurie gps ose të ngjashme

VLERA E FONDIT LIMIT: 39,326,900 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind Lekë pa TVSH.

Në Eur: 410,850.000 (katërqind e dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) Euro, pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.03.2026 është 95.72 Lekë/Euro;

I.ARGUMENTIMI I MOS NDARJES NË LOTE

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020,i ndryshuar të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “Posta Shqiptare” SH.A. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsyetimit te meposhtem:

Kjo kontratë nuk është ndarë në lote pasi ofrimi i shërbimit objekt kontrate është për **Mirëmbajtjen e sistemeve të integruara të sigurisë (sisteme CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto) dhe platformës së monitorimit të Posta Shqiptare sh.a** do të administrohet dhe monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme Posta Shqiptare SH.A, ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim si dhe do e bënte të pazbatueshme kontratën.

Objekti i kontrates lidhet me mirembajtjen e sistemeve te sigurise për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbime te Postes Shqiptare .

Përsa më lart ndarja në lote do ta ndërlikonte dhe vështirësonte procesin e zbatimit të kontratës duke krijuar vonesa dhe rrjedhimisht do sillte vështirësi pasi një pjesë e këtyre shërbimeve është ngritur mbi sistemet CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për Shërbimin e mirëmbajtjes së sistemeve të integruara të sigurisë (sisteme CCTV, alarmi, GPS/GPRS, sisteme vëzhgimi auto) dhe platformës së monitorimit të Posta Shqiptare sh.a”.

III. ARGUMENTIMI VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, Autoriteti ynë kontraktor, ka zbatuar parashikimet e Nenit 76 të VKM nr.285 pika 1 b duke marrë oferta nga operatorët ekonomik të fushës. Ofertat janë administruar në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit dhe janë pjesë e dosjes.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) *çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: do të jetë për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike nga fillimi i ofrimit të shërbimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; në vlerën **786,538 (shtatëqind e tetëdhjet e gjashtë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) lekë.**

Në Eur: 8,212.5 (tetë mijë e dyqind e dymbëdhjetë pikë pesë) Euro, pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 18.03.2026 është 95.72 Lekë/Euro;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve të fundit, **ku të paktën në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 95% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të

Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkojë, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve se ka jo më pak se 10 persona të punësuar për 3-

Muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 . ne te cilen të përfshihen :

- (a) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) **Inxhinier elektronik ose ekuivalent**, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figuroje në listpagesa për 3-muajt e fundit.
- (b) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) **specialist TIK/Informatike** (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi) **ose ekuivalent**, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figuroje në listpagesa për 3-muajt e fundit.
- (c) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) **Inxhinier Telekomunikacioni ose ekuivalent**, për të cilin operatori ekonomik të paraqesi diplomën përkatëse ose vërtetim diplome dhe duhet të figuroje në listpagesa për 3-muajt e fundit.
- (d) Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 3 (TRE) punonjes të deklaruar si **montues te pajisjeve elektronike** ose profesioneve ekuivalente. Për këtë OE duhet të paraqesi një deklaratë me emrat e tyre dhe duhet të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi sipas formatit E-sig. për periudhën e 3-muajve te fundit sipas kodit përkatës të profesionit referuar VKM 514 datë 20.09.2017.

Sqarim! Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime për të përmbushur kriterin më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Disponimi i stafit me specialistët e sipërcituar gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të **Shërbimit objekt kontrate: Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të vëzhgimit CCTV, sistemeve të alarmit, sistemeve të vëzhgimit në automjete, sistemeve GPS në automjete dhe mirëmbajtjes se programit të monitorimit të kamerave**, me shtrirje në të gjithë Shqipërinë, kohëzgjatjes të kontratës në 1 vit kalendarik. Të gjithë specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për realizimin e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike të kësaj procedure. Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesional për realizimin e kontratës.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.

2.3.3 Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet të ketë si pjesë të stafit të punësuar për 3-Muajt e fundit të paktën:

- (a) **2 (dy)** punonjës të certifikuar nga kompani të ndryshme prodhuese të pajisjeve GPS ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre e vertetuar me certifikatat perkatese dhe te figurojnë ne listë pagesat e sigurimeve shoqerore për periudhën e 3 muajve të fundit.
- (b) **2 (dy)** punonjës te certifikuar nga kompani të ndryshme prodhuese të pajisjeve të sistemeve të alarmit ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre e vertetuar me certifikatat perkatese dhe te figurojnë ne listë pagesat e sigurimeve shoqerore për periudhën e 3 muajve të fundit.
- (c) **2 (dy)** punonjës te certifikuar nga kompani të ndryshme prodhuese të sistemeve të vëzhgimit ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre e vertetuar me certifikatat perkatese dhe te figurojë ne listë pagesat e sigurimeve shoqerore për periudhën e 3 muajve të fundit.

Sqarim! Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime për të përmbushur kriterin më sipër.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) dhe c) të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Referuar faktit se do të mirmbahen dhe do të zëvendësohen pajisjet aktuale të cilat janë funksionale **sistemeve të vëzhgimit CCTV, sistemeve të alarmit, sistemeve të vëzhgimit në automjete, sistemeve GPS në automjete dhe mirëmbajtjes se programit të monitorimit të kamerave**, me shtrirje në të gjithë Shqipërinë, kohëzgjatjes të kontratës në 1 vit kalendarik, kërkohet që OE të ketë një staf punonjësish të certifikuar nga **kompani të ndryshme prodhuese** të pajisjeve GPS, sistemeve të alarmit, sistemeve të vëzhgimi si dhe të ketë jo më pak se 2 (dy) punonjës të pajisur me Certifikatën/Dëshminë e Sigurisë Teknike në punë . Të gjithë specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për realizimin e shërbimeve të kërkuara në sopecifikimet teknike të kësaj procedure. Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesional të nevojshëm dhe të kualifikuar për realizimin e kontratës. Periudha e kërkuar 3-mujore është minimale duke marrë në konsideratë që kjo është periudhë prove për çdo punonjës që punësohet në një subjekt në përputhje me Kodin e Punës.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale dhe kualifikimet e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të sigurojë AK që merr përsipër mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese: Kamerat Hikvision, Sistemet e Alarmit Messer GPRS dhe Radio, Sistemet GPS Meitrack dhe implementimin e tyre në platformën e menaxhimit.

Gjithashtu platformat që përdor Posta Shqiptare për menaxhimin e këtyre sistemeve janë :

- Platforma për menaxhimin e sistemeve të kamerave është Hikcentral
- Platforma për menaxhimin e sistemeve të alarmit është Kronos NET

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë suporti nga Prodhuesit ose Distributorët e Autorizuar të Sistemeve të mësipërme për periudhën 1-vjeçare të mirëmbajtjes.

O.E merr përsipër që do të suportoje AK për mirëmbajtjen e këtyre platformave dhe nderhyrjen për zgjidhjen e problemeve në rast të një avarie të mundshme Brenda 6 orësh nga njoftimi.

Argumentimi: Në bazë 37, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që referuar specifikimeve teknike operatori ekonomik ofertues të marrë përsipër mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese dhe të paraqesë një deklaratë suporti nga Prodhuesit e Sistemeve të mësipërme për periudhën 1-vjeçare të mirëmbajtjes aq sa është edhe afati i kohëzgjatjes së kontratës.

Referuar faktit se pajisjet janë të instaluar dhe kërkohet vetëm mirëmbajtja dhe zëvendësimi i tyre me produkte të të njëjtave marka, kërkesa për paraqitjen e një deklaratë suporti nga Prodhuesit e Sistemeve të mësipërme për periudhën 1-vjeçare të mirëmbajtjes, krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet teknike të nevojshme dhe të kualifikuar për realizimin e kontratës.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike të nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë 3 (tre) automjete për mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë, shoqëruar me kontratë shitblerje ose certifikatë pronësie ose kontratë qiraje të noterizuar si dhe për të gjitha mjetet të paraqitet certifikata e pronësisë, leje qarkullimi, vërtetim për taksat e paguara dhe siguracion i vlefshëm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika B. Mjetet dhe pajisjet e shërbimit, pika 1/b, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 9, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si*

provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojca 10, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin..”, Ofertuesi fitues, përpara lidhjes së kontratës duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.

NJËSIA E PROKURIMIT